



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Kuvendi - Skupština - Assembly*

---

**Legjislatura VI**

Sesioni vjeshtor

**Komisioni për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini, Sport, Inovacion dhe Ndërmarrësi**

Mbledhja nr. 44  
Prishtinë, më 12.11.2018, në orën 13:00  
Ndërtesa e Kuvendit, salla N- 303

**PROCESVERBAL**

**Në mbledhje morën pjesë:** Ismajl Kurteshi, kryetar, Teuta Haxhiu, Arbërie Nagavci, Driton Çaushti, Abdyl Salihu, Mufëra Shinik dhe Albulena Balaj – Halimaj.

**Mungoi:** Valentina Bunjaku – Rexhepi, Fidan Rekaliu, Verica Çeraniq dhe Nezir Cocaj,

**Përfaqësues të tjerë:** Mevlide Shamolli,- Ministria e Financave dhe përfaqësues të mediave.

**Stafi mbështetës i komisionit:** Shaip Goxhuli, Lule Ymeri dhe Rudinë Fetahaj.

Për këtë mbledhje u propozua ky:

**Rend i ditës:**

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 5.11.2018;**
- 3. Shqyrtimi i Projektligjit nr.06/L-073 për statusin e punëtorëve të arsimit shqip të Republikës së Kosovës nga viti shkollor 1990/91 deri në vitin shkollor 1998/99;**
- 4. Të ndryshme.**

Kryetari konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës së komisionit dhe e hapi mbledhjen sipas rendit të ditës.

**1. Miratimi i rendit të ditës**

Rendi i ditës u miratua pa vërejtje.

## **2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 05.11.2018**

Procesverbali, i mbledhjes së mbajtur më 05.11.2018, u miratua me propozimin e deputetes Teuta Haxhiu për plotësimin e diskutimit të saj lidhur me projektin për dëshmorin Nuhi Berisha, si dhe deputetes Arbërie Nagavci për përfshirjen e përgjigjeve të ministrit në pyetjet e parashtruara rreth heqjes nga repertori i dy shfaqjeve të autorëve shqiptarë nga Këshilli Drejtues, si dhe për shkeljet ligjore që janë bërë lidhur me shkarkimin e drejtorit të Teatrit Kombëtar.

## **3. Shqyrtimi i Projektligjit 06/L073 për statusin e punëtorëve të arsimit shqip të Republikës së Kosovës nga viti shkollor 1990/91 deri në vitin shkollor 1998/99**

**Ismajl Kurteshi** tha se lidhur me këtë projektligj është punuar gjatë, dhe nga diskutimet në mbledhjen e fundit janë dhënë janë propozuar disa variante për të cilat kemi kërkuar sqarim dhe analizë financiare nga Ministria e Financave.

**Mevlude Shamolli**, përfaqësuese e Ministrisë së Financave, tha se ministria ka analizuar dhe llogaritur koston buxhetore të propozimeve të dala nga komisioni dhe me këtë rast Ministria e Financave mbështet propozimin e parë të komisionit si më të favorshëm për buxhetin e Kosovës.

Ajo tha se kostoja për variantin e parë është 19,433,480 euro, për variantin e dytë 108,229,728 euro, për variantin e tretë 133,000,324 euro, si dhe varianti i katërt i propozuar për llogaritjen e shumës së kompensimit prej 88 euro për muaj pune ka kosto totale prej 160 milionë euro.

**Ismajl Kurteshi** kërkoi sqarim lidhur me dallimin shumë të koston financiare në mes variantit të parë dhe të dytë që i bie 19 milionë dhe 108 milionë.

**Mevlude Shamolli** sqaroi që varianti i parë është filluar më 2.5 %, ndërsa i dyti me 14 euro dhe që gjithashtu varianti i parë është llogaritur për 3 vjet, ndërsa në të dytin janë llogaritur për 9 vjet.

**Arbërie Nagavci** tha se qëndron prapa propozimit të saj për llogaritjen e kompensimit shtesë prej 88.41 € për muaj varësisht nga vitet e përvojës së punës, si dhe pagesën e menjëhershme pas daljes në pension të përfituesit. Ajo tha se me këtë propozim trajtohen në mënyrë të barabartë të gjithë punëtorët që kanë kontribuar në atë periudhë kohore dhe tha se është kundër propozimeve të tjera.

**Teuta Haxhiu** tha se po flasim për një periudhë 3 vjeçare siç është në projektligj dhe për shtesën, e jo për pensionin që ata e marrin. Mirëpo ajo theksoi që këto shifra nuk janë reale pasi që duhet marrë parasysh numrin e atyre që nuk janë më në jetë, atyre që hiqen nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, gjithashtu edhe ato familje që përfitojnë nga skemat e tjera, ligji nuk ua lejon të përfitojnë edhe nga ky ligj.

**Albulena Balaj – Halimaj** tha se për variantin e parë edhe të tretë duhet gjetur një mesatare dhe duhet vendosur në përqindje dhe jo në euro. Ajo gjithashtu tha se Ministria e Financave duhet të afrojë informata të sakta deri tash sa kanë dalë në pension, si dhe për çdo vit sa i kushton

buxhetit të Kosovës. Ajo gjithashtu tha se duhet të vendoset mënyra e shpërndarjes në këste apo si pension mujor.

**Driton Çausi** tha se është shumë e rëndësishme të dihet kostoja totale sepse është barrë që trashëgohet përtej 3 viteve, çfarëdo vendimi që merr komisioni. Ai tha se pensionistët, si kategori shoqërore, nuk rregullohen me pensione të veçanta dhe vetëm në momentin që kemi pensione dinjitarë për të gjithë, vetëm atëherë është bërë një zgjidhje, shtoi ai. Në anën tjetër, ai theksoi që kjo që po ndodh me këtë ligj është e pa shembulltë sepse po hap rrugë për shumë ligje të tjera në Kosovë. Gjithashtu ai tha se kjo kategori është paguar në kohën kur ka shërbyer dhe se të gjithë janë të vetëdijshëm për buxhetin modest të Republikës së Kosovës. Po ashtu, ai tha që të gjitha kritikantët që janë bërë nga FMN, nga Banka Botërore, nga Ministria e Financave dhe nga organizata e ndryshme, sipas tij, nuk janë qëllimkeqe, por me bazë sepse e rrezikon qëndrueshmërinë buxhetore. Ai tha se merr parasysh të drejtën e kategorive të tjera për përfitime, duhet pasur në konsideratë edhe qeveritë e ardhshme për vendimin të cilin e merr komisioni dhe jo vetëm tre vitet e ardhshme, por për një periudhë afatgjatë. Ai propozoi të shqyrtohet opsioni i parë dhe të mos mbyllet sytë para një rreziku afatgjatë.

**Abdyl Salihu** tha se është mirë që të analizohen të gjitha propozimet dhe të përcaktoheni bashkërisht për propozimin si cili është më i favorshëm dhe gjënë zbatim në praktikë.

**Ismajl Kurteshi** tha se anëtarët e Komisionit duhet të deklarohen me votë lidhur me propozimin që pagesa e kompensimit shtesë pas daljes në pension të bëhet për çdo muaj apo kompensimi shtesë të merret komplet pas daljes në pension.

Anëtarët e Komisionit me shumicë votash vendosen që pagesa e kompensimit shtesë pas pensionimit të përfituesit të bëhet për çdo muaj dhe pagesa e kompensimit shtesë të bëhet sipas propozimit të dytë e shprehur në përqindje.

Anëtarët e komisionit vazhduan me shqyrtimin e projektligjit nen për nen dhe u propozuan amendamentet si vijon:

#### **Amendamenti 1**

Në titullin e projektligjit fjala "PROJEKTLIGJ" zëvendësohet me fjalën "LIGJ".

#### **Amendamenti 2**

Neni 1, ndryshohet si vijon:

Qëllimi i këtij Ligji është njohja e përvojës së punës dhe përcaktimi i të drejtave në kompensim shtesë mbi pensionin bazë të përfituesit, për punëtorët e arsimit shqip të Republikës së Kosovës që punuan nga viti shkollor 1990/91 deri në vitin shkollor 1998/99.

#### **Amendamenti 3**

Neni 2, paragrafi 1 ndryshohet si vijon:

1. Fushëveprim i këtij Ligji është përcaktimi i të drejtave në kompensim shtesë për punëtorët e arsimit shqip të Republikës së Kosovës që punuan nga viti shkollor 1990/91 deri në vitin shkollor 1998/99.

#### **Amendamenti 4**

Neni 2, nënparagrafët 1.1; 1.2; 1.3 dhe paragrafi 2 fshihen.

#### **Amendamenti 5**

Neni 3, paragrafët 10 dhe 11 fshihen.

#### **Amendamenti 6**

Neni 3, paragrafi 12 ndryshohet si vijon:

12. Drejtori dhe zëvendësdrejtori/ndihmësdrejtori i shkollës - udhëheqës dhe menaxhues të shkollës.

#### **Amendamenti 7**

Neni 3, paragrafët 17; 20; 21; dhe 26 fshihen.

#### **Amendamenti 8**

Neni 4 fshihet.

#### **Amendamenti 9**

Neni 5 fshihet.

#### **Amendamenti 10**

Neni 6, ndryshohet si vijon:

#### **Neni 6**

#### **Përfituesit e kompensimit shtesë**

1. Personi i pensionuar i cili ka punuar në arsimin shqip të Republikës së Kosovës nga viti shkollor 1990/91 deri në vitin shkollor 1998/99, gëzon një kompensim shtesë për kontributin e dhënë.

2. Përfituesit e kompensimit shtesë janë:

- 2.1. Mësimdhënësit;
- 2.2. Bashkëpunëtorët profesional;
- 2.3. Drejtori dhe zëvendësdrejtori i shkollës;
- 2.4. Personeli administrativ;
- 2.5. Personeli teknik i shkollave;
- 2.6. Të punësuarit në arsimin e lartë sipas sistemit të arsimit shqip.

#### **Amendamenti 11**

Neni 7 ndryshohet si vijon:

#### **Neni 7**

## **Kategoritë e përfituesve të kompensimit shtesë**

1. Përfituesit e kompensimit shtesë kategorizohen bazuar në vitet e punës së tyre nga viti shkollor 1990/91 deri në vitin shkollor 1998/99, ku për çdo vit pune, mbi pensionin bazë, përfitojnë shumën e përqindjes të pagës bazë në arsimin fillor të Republikës së Kosovës, si vijon:

- 1.1. 1 (një) vit pune 3.46%;
- 1.2. 2 (dy) vite pune 5.19%;
- 1.3. 3 (tre) vite pune 6.91%;
- 1.4. 4 (katër) vite pune 8.64%;
- 1.5. 5 (pesë) vite pune 10.37%;
- 1.6. 6 (gjashtë) vite pune 12.10%;
- 1.7. 7 (shtatë) vite pune 13.83%;
- 1.8. 8 (tetë) vite pune 15.56%;
- 1.9. 9 (nëntë) vite pune 17.28%.

### **Amendamenti 12**

Neni 8 fshihet.

### **Amendamenti 13**

Neni 9 ndryshohet si vijon:

MASHT me akt nënligjor përcakton procedurat për njohjen dhe vlerësimin e kontributit për pronarët e shtëpive shkolla dhe objekteve të tjera.

### **Amendamenti 14**

Neni 10 ndryshohet si vijon:

#### **Neni 10**

#### **Parashtrimi i kërkesës për realizimin e të drejtës në kompensim shtesë**

MASHT në bashkëpunim me MPMS dhe MF, hartojnë akt nënligjor i cili përcakton kushtet dhe kriteret për realizimin e të drejtës në kompensim shtesë.

### **Amendamenti 15**

Neni 11 ndryshohet si vijon:

#### **Neni 11**

#### **Afati për realizimin e të drejtës në kompensim shtesë**

1. Të drejtat për realizimin e kompensimit shtesë për kategoritë e përcaktuara me këtë ligj, realizohen nga dita e pensionimit.

2. Afati për realizimin e kompensimit shtesë për kategoritë e përcaktuara në këtë ligj, realizohet pas hyrjes në fuqi të këtij ligji.

### **Amendamenti 16**

Neni 12 ndryshohet si vijon

**Neni 12**  
**Parashtrimi i kërkesës për kompensim shtesë**

1.Kërkesën për kompensim shtesë për kategoritë e përcaktuara me këtë ligj, mund ta parashtrojë përfituesi apo personi i autorizuar nga ai, ose bashkëshorti/ja pas vdekjes së përfituesit.

2.Për realizimin e së drejtës në kompensim shtesë, sipas dispozitave të këtij ligji, aplikuesi e paraqet kërkesën në Zyrën Rajonale të Departamentit për pension pranë MPMS.

3.Bashkëshorti/ja, pas vdekjes së përfituesit, është i obliguar të informojë me shkrim administratën pensionale të Kosovës për çdo ndryshim të rrethanave të cilat ndikojnë në fitimin e të drejtës për marrjen e kompensimit shtesë.

4.Administrata pensionale e Kosovës, si njësi administrative brenda Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale, menaxhon dhe administron pagesën e kompensimit shtesë sipas këtij ligji.

**Amendamenti 17**

Neni 13 fshihet.

**Amendamenti 18**

Neni 14 ndryshohet si vijon:

**Neni 14**  
**Aktet nënligjore**

Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë brenda 6 (gjashtë) muajsh nga hyrja në fuqi e këtij ligji nxjerr aktet nënligjore për zbatimin e tij.

**Amendamenti 19**

Neni 15 fshihet.

Komisioni me shumicë votash miratoi amendamentet e propozuara në Projektligjin nr.06/L-073 për statusin e punëtorëve të arsimit shqip të Republikës së Kosovës nga viti shkollor 1990/91 deri në vitin shkollor 1998/99, dhe raportin me amendamente e procedon te komisionet e përhershme.

**4. Të ndryshme**

Për këtë pikë të rendit të ditës nuk pati diskutime.

Mbledhja përfundoi në orën 16:10.

*E përgatiti:*

*Stafi mbështetës i Komisionit.*

**Kryetari i komisionit,**

-----

**Ismajl Kurteshi**